



Pranuar / Dorezuar Prilipim/Protokol Received/Delivery	10.10.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organi / Jednica Org. Unit	No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS#HCK	6051/2022		116

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.117/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1181/2019 të datës 23.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.117/2019 të datës 20.02.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër Vendimit me numër 04-052-159 të datës 01.02.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.117/2019 e datës 20.02.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 04-0525-159 i datës 01.02.2019 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Vendimi me numër 04-052-2028 i datës 19.12.2018 i Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

A r s y e t i m

Agjencia e Statistikave të Kosovës në bazë të autorizimit të datës 11.09.2018 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 13.09.2018 ka shpallur konkursin për vendin e punës "Zyrtar për Statistika të Investimeve", ASK-DSE-008. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë) dhe sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10) ankuesja është renditur e para në listën e kandidatëve të suksesshëm me 92.23 pikë.

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave, me datë 19.12.2018 ka nxjerrë vendimin me numër 04-052-2028 me të cilin vendim e ka anuluar raportin e rekomandimit të datës

25.10.2018 nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit për kandidaten e suksesshme për pozitën "Zyrtare për Statistika të Investimeve" dhe në diapositivin e dytë të këtij vendimi në pozitën "Zyrtar për Statistika të Investimeve" emërohet kandidatja e dyta me radhë me vlerësim nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit.

Ankuesja kundër vendimit të datës 19.12.2018 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me datë 11.01.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 04-052-16 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me datë 01.02.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër 04-052-159 me të cilin vendim e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me numër 04-052-16 të datës 11.01.2019 të parashtruar nga ankuesja

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin e datës 01.02.2019 me numër 04-052-159 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me datë 20.02.2019 parashtron ankesë me numër të protokollit 876/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 17.04.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1181/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.04.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 20.02.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.05.2022 me numër të protokollit 3086/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1181/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.02.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Statistikave të Kosovës. Agjencia e Statistikave të Kosovës, më datë 25.02.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 27.06.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin A.nr.117/2019, sipas të cilit e ka pezulluar procedurën lidhur me ankesën e ankueses të datës 20.02.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshill, me arsyetimin se ankuesja kundër Vendimit të datës 01.02.2019 me numër 04-052-159 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ka parashtruar kërkesë për opinion ligjor tek Agjencia Kundër Korrupsionit, lidhur me

ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit me Kryeshefin Ekzekutiv të atëhershëm të ASK-së, sepse pasi që është rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës i rekrutimit si kandidate e suksesshme për pozitën: “Zyrtare për Statistika të Investimeve”, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës me datë 19.12.2018 nxjerrë Vendim me nr. 04-052-2028 me të cilin vendim e anulon raportin e rekomandimit të datës 25.10.2018 dhe emëron kandidaten _____ e dyta me radhë e vlerësuar nga Komisioni përzgjedhës i rekrutimit, sipas Opinioneve zyrtare të rekomandimit të datës 05.12.2018 të Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me situatën e konfliktit të interesit respektivisht lidhjes familjare të kandidates së përzgjedhur _____ me Kryeshefin Ekzekutiv të ASK-së.

Mbi këtë bazë ankuesja me datë 07.09.2022 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin të vendimit A.nr.117/2019 të datës 27.06.2022, meqenëse e njëjta ka qenë e pezulluar, për ankesën e datës 15.04.2019 me Aktgjykimin e datës 1181/2019 të datës 23.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, pasi që e ka pranuar përgjigjen-opinionin ligjor nga Agjencia Kundër Korrupsionit të datës 20.07.2022, sipas kërkesës së saj drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pasi që ka pranuar Kërkesën e ankueses të protokolluar me numër 5192/20122 të datës 07.09.2022, të bashkangjitur dhe përgjigjen në kërkesën respektivisht opinionin ligjor të protokolluar me numër DPKI/06-2919/22 nga Agjencia Kundër Korrupsionit të datës 20.07.2022, **Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Përgjigjes me numër protokoll 06-2919/22 të Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 20.07.2022 të Drejtorit të Departamentit të Parandalimit të Konfliktit të Interesit; Aktgjykimi A.nr.1181/19 i datës 23.05.2022 e Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A.nr.117/2019 i datën 27.06.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 17.04.2019; Ankesën e ankueses të datës 20.02.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 01.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencinë e Statistikave të Kosovës; e-mail i datës 14.12.2018; Tabela e kandidatëve me pikë nga lista e ngushtë dhe intervistë e datës 14.12.2018; Vendimi i datës 19.12.2018 i Kryeshefit Ekzekutiv i Kryeshefit Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Përgjigja nga Agjencia e Kundër Korrupsionit e datës 05.12.2018 me numër 03.02/4332/18 për Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Njoftimi i datës 14.12.2018; Njoftimi i datës 14.12.2018 për kandidatin e suksesshëm; Renditja përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10); Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues (Form.MAP-SHCK-11); Lista e ngushtë e datës 12.10.2018; Formulari për të përcaktuar kriteret e zgjidhjes së ngushtë përfundimtare; Regjistri i aplikacioneve të pranura (Form.MAP-SHCK-04) i datës 13.09.2018 dhe 01.10.2018; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilën kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë (Form.MAP-SHCK-05); Propozimi për emërim i datës 25.10.2018; Vendimi i datës 28.09.2018 për formimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Deklarata e datës 26.09.2018 e Udhëheqëses së Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; Vendimi i datës 16.10.2018 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Autorizimi për publikimin e konkursit i datës 11.09.2018 i lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil; Konkursi i datës 13.09.2018; Kërkesa për punësim e datës 27.09.2018 (Form. ZKM/ASK-SHCK-03) e kandidates _____ me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 25.09.2018 (Form.ZKM/ASK-SHCK-03) e kandidates _____ me dokumentacionin

e bashkangjitur; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHVK-08); Testi me shkrim; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe njoftimi/kërkesa e ankueses e datës 14.06.2022 e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankueses e cili ka pretenduar se është shkelur ligji i shërbimit civil dhe rregullorja për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, po ashtu kandidatja pretendon se emri i saj nuk gjendet në listën e kandidatëve të poentuar që është shpallur në tabelën e shpalljeve të Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe që është njoftuar nga Zyra e Personelit të Agjencisë së Statistikave, se ka qenë kandidatja me më së shumti pika.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës nga organi i punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka konstatuar se ankuesja Andeta Krasniqi ka qenë kandidatja e cila sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10), është renditur e para në listën e kandidatëve të përzgjedhur me gjithsej 92.23 pikë dhe se me datë 25.10.2018 Menaxherja e Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, e ka përcjell tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës rekomandimin për emërim, mirëpo Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nuk e ka emëruar ankuesen/kandidate të përzgjedhur Andeta Krasniqi në pozitën "*Zyrtare për Statistika të Investimeve*", pasi që mendon se ka konflikt interesi me ankuesen si kandidate e përzgjedhur. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përmes Zyrës Ligjore të ZKM-së me datë 30.10.2018 i është drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit, me shkresë zyrtare me numër të protokollit DPK-03-02/3830/18 për të shqyrtuar gjendjen e mundshme të konflikt interesit me kandidaten e përzgjedhur

Drejtori i Departamentit të Parandalimit të Korrupsionit në Agjencinë Kundër Korrupsionit, me datë 05.12.2018 ka nxjerrë përgjigjen me referencë AKK-DPK-03-02-2613/18 lidhur me kërkesën numër të protokollit DPK-03-02/3830/18 të datës për Kryeshëfin Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, se ekziston konflikti i interesit me kandidaten e përzgjedhur si e para në listën e kandidatëve të suksesshëm, dhe e rekomandon që të bëjë përzgjedhjen e kandidatit tjetër në rashën e kandidatëve që ka dalë i suksesshëm me më së shumti pika, në pajtim me dispozitat ligjore të nenin 5 të paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, pasi ka pranuar përgjigjen me referencë AKK-DPK-03-02-2613/18 nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ka ndërmarr veprime konform kompetencës dhe me datë 19.12.2018 ka nxjerrë Vendimin me numër 04-052-2028 me të cilin ka anuluar raportin me rekomandim të datës 25.10.2018 nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit për kandidaten e suksesshme nga procedura e rekrutimit për pozitën "*Zyrtare për Statistika të Investimeve*", dhe e rekomandon për këtë pozitë kandidaten *e dyta e listuar në listë me pikët e arritura 76.46% pike në radhe, e vlerësuar nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar ligjshmërinë e procesit të rekrutimit për vendin e punës "Zyrtar për Statistika të Investimeve", me referencë ASK-DSE-008, ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv me rastin e marrjes së vendimit me numër 04-052-2028 të datës 19.12.2018 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 19 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që është përcaktuar se: "1. Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil" dhe "3. Nëse shkresa e punësimit nuk kthehet e nënshkruar nga kandidati i pranuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e njoftimit, atëherë punësimi i afrohet kandidatit tjetër me radhë në listën e kandidatëve, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parapara me akte nënligjore", po ashtu dhe me dispozitat e nenit 9 paragrafit 3 të Rregullores Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil është përcaktuar se: "Nëse kandidati e kthen Akt emërimit e pa nënshkruar, ose ky dokument nuk kthehet fare brenda afatit të përcaktuar, kandidati konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për emërim. Në raste të tilla, Menaxheri i Personelit, pas vërtetimit se kandidati për emërim ka hequr dorë nga emërimi, atëherë kontakton kandidatin, i cili radhitet i dyti në listën e kandidatëve të përzgjedhur", mbi këtë bazë Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ka ndërmarre veprimet juridike administrative për çështjen e procedurës së rekrutimit që lidhet me emërimin e kandidates së dytë me radhë për emërim në pozitën "Zyrtar për Statistika të Investimeve", duke vepruar konform kompetencës ligjore të dëshmuar dhe vërtetuar nga përgjigjja me numër referencë AKK-DPK-03-02-2613/18 e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në kuptim të shmangies së konfliktit të interesit, të cilën e vërteton dhe përgjigjja/opinionin ligjor i Agjencisë Kundër Korrupsionit i datës 20.07.2022 i protokolluar me numër DPKI/06-2919/22, ku ankueses i është përgjigjur, se citoj: " Agjencisë së Kundër Korrupsionit në bazë të mandatit detyrave dhe përgjegjësiave përpiqet që të evitoj dhe parandaloj situatat e vendimmarrjes me konflikt të interesit për zyrtarët e lartë d.m.th. opinionin i Agjencisë i asaj kohe, ka qenë në relacion me Kryeshefi Ekzekutiv si zyrtar i lartë publik, e jo me juve personalisht, si kandidat për punësim.....keni në konsideratë faktin se në një periudhë të caktuar kohore ju keni qenë e kualifikuar për pranim, por situata e paraqitur ju ka bërë që të mos merrni detyrën".

Andaj lidhur me këto që u tha si më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv nuk ka mundur që në pozitën "Zyrtar për Statistika të Investimeve", ta emëroj kandidaten e parë ankuesen, me qenë se ka rënë ndesh me konflikt të interesit të përcaktuar në nenin 3 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, siç e ka konstaton përgjigjja me numër referencë AKK-DPK-03-02-2613/18 e Agjencisë Kundër Korrupsionit, se ekziston konflikt interesi në mes Kryeshefit Ekzekutiv dhe kandidates së përzgjedhur

duke ju referuar dispozitave ligjore të këtij ligji me rastin e paraqitjes së konfliktit të interesit, lidhur me detyrimin për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit dhe parimeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryeshefit Ekzekutiv në kuptim të interesit të institucionit, i njëjti e ka emëruar kandidaten me radhë me më së shumti pika e renditur e dytë në listën përfundimtare, pasi që ndaj kandidates së parë ankueses, është vërtetuar konflikti i interesit në raport me zyrtarin e lartë administrativ të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për ta përzgjedhë dhe emëruar në ushtrimin e detyrës në pozitë "Zyrtar për Statistika të Investimeve", me të cilat dispozita ligjore është parandaluar vendim marrja e tij në raport me ankuesen.

Bazuar në Vendimin e datës 19.12.2018 me numër 04-052-2028 të nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për emërimin kandidates



në vendin e punës "Zyrtar për Statistika të Investimeve" e renditur e dyta në renditur në listën përfundimtare nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit, ka vepruar në pajtim me kompetencën ligjore si dhe në dispozitat ligjore për shmangia e konfliktit të interesit respektivisht parimet themelore të shërbimit civil të përcaktuara në nenin 5 të paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencinë e Statistikave të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 04-052-159 të datës 01.02.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil si dhe të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, në raport me Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.117/2019

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsorë Gashi-BIRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.